

	Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing	
01	04 - 20
Tarih/Dt.	30.04.2020

P R O C E S V E R B A L

Mledhja e 03 e Rregullt e Asamblese Komunale është mbajtur me datë 30.04.2020 në ora 10:00 ne sallen e Asamblesë Komunale.

Mbledhja është udhehequr nga Kryesuesi i Kuvendit Z.Buyar Mazrek.
Në maledhje kanë marrë pjesë 13 anëtarë

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Të nderuar anëtarë të Asamblesë, të nderuar misafirë mirë se erdhët në mbledhjen e 03 të rregullt të Asamblese Komunale për vitin 2020. Mledhja është mbajtur në ora 10:00.

Rendi i dites:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;
3. Vlerësimi i gjendjes aktuale të coronavirusit dhe masat e ndërmarra nga komuna
4. Të ndryshme.

1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .**

Të nderuar anëtarë , a ka dikush diçka me shtu në lidhje me procesverbal, nëse jo atëherë votojmë.

-Po 13

-Jo 0

-abstenim 0

Me vota unanime prosesverbali u pranua.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;**Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .**

A ka dikush diqka me shtu në rend te ditës nëse jo atëherë votojmë.

Me vota unanime rendi i dites u pranua.

3.Vlerësimi i gjendjes aktuale të coronavirusit dhe masat e ndërmarra nga komuna**Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .**

Për më tepër spjegime rrëth kësaj pike fjalën ia japim Kryetarit të Komunës Z. Abdülhadi Krasniç.

Kryetarit të Komunës Z. Abdülhadi Krasniç.

Ju përshendes të gjithëve, edhe një herë urime muaji I shenjtë I ramazanit, allahu ishalla na pranon agjërimin. Sa I përket maledhjes së sotme sipas vendimit që e kemi marrë nga Ministria e Shëndetësisë në kushtë normale nuk lejohet mbajtja e maledhjeve të kuvendev, përvrq për komunat që janë të obliguara që të ndajnë buxhet për qështje emergjente. Sa I përket gjendjes aktuale të virusit Corona duhet edhe anëtarët

e kuvendit të jenë të informuar. Pas vendimit të marrë nga Ministria e Shëndetësisë edhe komuna janë e ka formuar shtabin e emergjencav, shtab ky I formuar në të gjitha komunat. Të gjitha vendimet e marra nga qeveria dhe institucionet e Kosovës u dërguan në këtë njësi, dhe ne u mblohdhëm me urgjencë dhe krijuam njësinë e veprimit emergjent. Në këtë njësi janë: kryetari I komunës, Drejtoret e drejtive dhe shefi i stacionit policor. Ne kemi zbatuar në mënyrë rigorozë të gjitha vendimet e marra nga Ministria e Shëndetësisë e Kosovës. Kishte 3 inspektorë në komunën tonë dhe I treguan ndërmarrjeve për masat e marra. Ndoshta edhe keni ndësgjuar, kryeinspektori ynë Z. Husein Bilibani është shumë I sëmurë, unë kam qenë në spital dhe e kam vizituar. Inspektorët tanë mbyllën disa vende pune, disa i lejuan por me kusht (Maskë, doreza dhe mbajtje e distancës). Gjithashtu I kemi njoftuar edhe pronarët e ndërmarrjeve të auto pjesëve për mbylljen e tyre. Shansi ynë më i madh është që shumica e Mamushës merret me bujqësi. Punëtorët e bujqësisë filluan të lejohen 1.5 orë në ditë. Si të gjitha komunat, ne kemi ndërhyrë dhe i kemi lejuar ata të punojnë nga ora 06:00 të mëngjesit deri 20:00 të mbrëmjes. Në ditën e 1 të Ramazanit, disa kafe janë të hapura. Ankesat e të gjitha kryetarëve të gjitha komunave është që qyteratë mund të durojnë 1 muaj ose dy pa dalur por jo më gjatë. Kosova nuk ka kushte. Shtetet e forta si Gjermania dhe Zvicra mund ti mbulojnë kët humbje por mbi të gjitha më I rëndësishëm është shëndeti dhe shyqyr prej zotit në 3-4 komuna nuk ka pasur asnjë rast të infektuar edhe tek ne nuk ka. Frika ime e vetme është që pasi që qytetarët tanë po punojnë në fushë të hapur nëse del 1 rast pozitiv atëherë do të shpërndahet shumë shpejtë. Frika tjetër është që vatër e virusut është bërë edhe reparti I hemodializës në Prizren dhe ne e kemi një pacient I cili e kryen dializën aty por ishalla zot e ruan atë, familjen dhe gjithë Mamushën. 1 rast nga Dragashi dhe 1 nga Rahoveci janë nga reparti I dializës. Nëse dikush del pozitiv në Mamushë atëherë as produktet që prodhojmë nuk do të shiten. 2 qytetarë nga Malishevë kanë ardhur në Mamushë por Policia arrestoi menjëherë dhe I ktheu përsëri ne qytetin e tyre. Mamusha është një zonë e hapur dhe shumica e tyre janë të angazhuar në bujqësi. Ky vit ka shku qysh ka shku por Ministria e Shëndetësisë po përpinqet të shpëtojë vitet e ardhshme. Dasmat, ahengjet tona do të ndryshojnë, do të shmanget qëndrimi kallaballak. Për të gjitha këto kopmetente ëshë Organizatës Botërore të Shëndetit. Do të ketë normalizim sipas fazave. Qytetarët mund të shërbehet me kafe në kafetire dhe të dalin jashtë. Nëse nuk arrihet niveli i dëshiruar, pas 18 majit do të ketë rregulla më të rrepta sesa lirimi. Të gjithë mendojmë që është një virus normal, pornë fakt është një virus shumë i rrezikshëm ku një person mund të infektojë 150 njerëz. Virusi në monedha të hekurta jeton 9 orë. Aktivitetet që I kemi realizuar ne si komunë në bashkëpunim me organizata tjetra janë:

Halil Kastrati nga Shoqata bamirëse "Jetimat e Ballkanit" ka sjellur 50 pako ushqimore në vlerë 50 euro për familjet në nevojë. Përveç kësaj, TIKA shpërndau 50 pako ndihmëse dhe një kompani në Suhareka shpërndau pije. Edhe UNICEF ka shpërndarë 50 pako ushqimore. Njerëzit kanë nevojë për më shumë ndihmë. Krahasuar me Kosovën, Mamusa është ekonomikisht pak më e mirë. Gjithashtu iu kemi drejtur edhe republikës së Turqisë për ndihmë rrëth 4000 pako ushqimore, përveq kësaj kemi kërkuar ndihmë edhe nga komuna e Bursës por për shkak të pandemisë nuk po mund të na ofrojnë ndihmë Gjithashtu jemi duke pritur përgjigje edhe nga Gjysmëhëna e kuqe turke. Këto ishin masat e marra brenda 1 muaji. Le ti paralajmërojmë edhe njëherë të afërmëtanë që mos të dalin jashtë pas iftarit. Duhet të ruajmë distancën, kjo është situata aktuale.

4.Të ndryshme

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

A ka dikush diqka me shtu në të ndryshmet?

Të nderuar anëtarë nëse nuk keni diqka me shtu në të ndryshmet atëherë mledhja ka përfunduar.
Faleminderit për pjesmarrje,

Proces mbajtësi
Idriz Mazrek

Kryesuesi i Kuvendit
Buyar Mazrek